

“NE dhe SHQIPJA”

Dr. Erida Curraj

Qendra "Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim" (SCiDEV) organizoi sëbashku me Shoqatën e Gjuhësisë Shqiptare dhe KS Faktor në datën 16 Maj, Webinarin nr 4 "Ne dhe Shqipja". Në këtë takim virtual u mbledhën kërkues, studiues dhe profesorë të gjuhës shqipe, studentë dhe të tjerë të interesuar, për të diskutuar për gjuhën shqipe, për përdorimin e saj në ligjërimin e shkruar dhe në ligjërimin e folur publik, për evoluimin e saj, si edhe për ruajtjen, lëvrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë.

Gjuha në vetvete është një organizëm i gjallë që evoluon në kohë dhe si e tillë i përgjigjet emancipimit të shoqërisë, kulturës e teknologjisë. Platformat digjitale të komunikimit dhe rrjetet sociale kanë sjell një shpërfillje të thellë në përdorimin publik të gjuhës shqipe. Ligjërimi i shkruar nuk kalon në filtrin e redaktimit dhe ligjërimi i folur nuk kalon në filtrin e monitorimit, për pasojë vërehen shmangie nga normat e gjuhës dhe natyrshëm lind shqetësimi - A po tjetëron gjuhën shqipe përdorimi i rrjeteve sociale? A mund të quhen faktorë vetëm rrjetet sociale për tjetërsimin e gjuhës shqipe? Çfarë ndikon në deformimin e gjuhës shqipe në titrat e lajmeve e filmave, në tekstet e reklamave promovuese, apo edhe në shtypin e përditshëm, në revista e deri në botime shkencore?

Shqetësimet që zgjon, sidomos dy dekadat e fundit, përdorimi publik i gjuhës shqipe nuk mund të kufizohet vetëm me problematikat aq të qenësishme të sistemit arsimor. Një vëmendje e veçantë dhe e merituar i kushtohet zgjerimit të komunikimit me shkrim përmes rrjetit duke mos respektuar rregullat e gramatikës dhe sintaksës. Nisur nga një aktualitet i tillë, gjatë takimit u parashtruan se si, në thelb, gjuha e shkruar gjymtohet pasi, ajo pëson të meta që në zanafillë, që në procesin e leximit. Ky i fundit është shumë i rëndësishëm pasi, në një masë të madhe, prirja e përgjithshme është ajo e përcjelljes së të njëjtave boshllëqe gramatikore, drejtshkrimore e deri semantike nga leximi në shkrim. Shkruhet keq pasi lexohet pak e këtu, debati zgjerohet dhe përfshin industrinë e leximit të librit, shtypin (e shkruar ose virtual), mediat audio-vizuale etj.

Takimi ishte shumë i sukseshëm se jo vetëm nxorri në pah disa nga problemet më emergjente dhe më të rëndësishme që çënojnë cilësinë e gjuhës shqipe por edhe u adresuan disa zgjidhje të tyre, ato janë të disa niveleve, nivel strategji kombëtare, institucional dhe individual.

Prof. Dr. Rami MEMUSHAJ, Gjuhëtar dhe Studiues dhe pjesëtar i "Shoqatës të Gjuhësisë Shqiptare" theksoi se burimet mediatike kanë një rol të padiskutueshem si në misionin e shpërndarjes të gjuhës shqipe standarte brenda dhe jashtë kufijve, por nga ana tjetër e ka devijuar atë. Përpara viteve 90' shtypi i shkruar ka patur përparësi, jo vetëm sepse lexohej masivisht por edhe sepse mjetet e komunikimit mungonin krahasuar me ditët e sotme. Numri i televizioneve është rritur shumë dhe shtypi i shkruar është lenë pas dore rrjedhimisht edhe redaktimet apo filtrat paraprak të gjuhës shqipe, përpara se atjo të mbërrijnë tek qytetari. Nga monitorimi që profesori personalisht ka realizuar vetëm në territorin e Shqipërisë dhe Kosovës ka 582 kanale të tilla. Duke i'u referuar INSTAT-it vetëm 10% e shqiptarëve përdorin median e shkruar, pjesa tjetër e marim lajmin nga Televizionet dhe nga

Radiot. Por kjo rritje e numrit te kanaleve televizive dhe radiove nuk ka ecur me të njëjtin ritëm për kualifikimin e operatorëve, folësve të lajmeve dhe prezantuesve të emisioneve.

Cila mund të jetë zgjidhja?

Profesori sugjeron që një nga zgjidhjet mund të jetë trajnim i vazhdueshëm i Folësëve Televiziv - ky është një trajnim që Katedra e Gjuhës Shqipe duhet t'ua ofrojnë papagesë. Nga ana tjetër vet televizionet duhet t'i afrohen universiteve dhe t'i kërkojnë trajnime apo staf të kualifikuar prej tyre.

Kurse Dr.Edon QESARI, e lidh problemin e dobësimin të gjuhës shqipe në **nivel strategjik** të *arsimit parauniversitar* -duhet letërsia të vazhdojë të jepet përkrahë gjuhës shqipe- thotë ai. Ndarja e gjuhësisë nga letërsia është si të ndash teorinë nga praktika. Dhe akoma më tepër kjo shpëputje e gjuhës shqipe në nivelin e shkollës të mesme "përgatit" studentë për të aplikuar në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Gjuhë Shqipe e Letërsi. Shpëputja e teorisë nga praktika ka sjellë faktin që të gjithë jemi si të automatizuar, flasim me atë shkurtësi apo dobësi gjuhësore sepse këto janë bazat që jemi përgatitur- shton prof Qesari. Po t'i referohemi shteteve si Italia dhe Greqia, dallimi është i dukshëm në mënyrën e ndërtimit të sintaksës nga popullata e gjerë, ajo është shumë e saktë. Kjo vjen pasi ata mësojnë në shkollë Italishten e vjetër dhe Greqishten e vjetër, duke lejuar që të hedhin bazat të shëndetshme të "arkitekturës" të gjuhës.

Por, nga ana tjetër, sipas mendimit të Dr. Mirjam Reçi, me diplomë në Gjuhën Shqipe dhe Letërsi, nëse sistemi arsimor 9-vjeçar do të jetë i kompletuar dhe serioz, do të jetë mëse i mjaftueshëm për të arritur rezultate shumë të mira të folurit dhe të shkruarit të gjuhës shqipe. Shumë prej nesh, pavarësisht se nuk jemi shkolluar në të njëjtin sistem me atë të ditëve të sotme, ku gjuha shqipe nuk vazhdonte pas klasës të 8-të, kjo nuk na pengoi të arrinim rezultate të shkëlqyera, ashtu siç nuk më pengoi edhe mua të arrija rezultate shumë të mira për t'u diplomuar në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi.

Këtij mendimi ju bashkua edhe L.Kalaja, themeluese e një prej qendrave që ofron kurse të gjuhëve të huaja, parashtrori vështirësitë që hasin studentët në mësimin e gjuhëve të huaja. Sipas saj, padyshim kjo vjen për arsyet e sipërpërmendura pasi mungojnë njohuritë në gramatikë, sintaksë dhe morfologjinë e gjuhës shqipe dhe mangësive në kurrikulat e saj në sistemin arsimor 9- vjeçar dhe atij të mesëm.

Pika tjetër që i referohet sistemit të arsimit por kësaj rradhe *universitar* ka të bëjë me të vetmen kurrikul që lidhet me shkrimin dhe leximin e gjuhës shqipe në institucionet e arsimit të lartë "Shkrimi Akademik". Sipas Dr.Qesari ajo është pothuajse inekzistente pasi studentët duhet të marrin në të përgatitje se si duhet të shkruajnë një tekst akademik, një tezë diplome bachelori, master apo doktorature. -Dëshmitë dhe rezultatet e revolucionit nëpër auditoret e sotme, tregojnë sa jo e sukseshme ka qenë kjo praktikë". Nevoja e përmisimit të kurrikulës u mbështet edhe nga profesorët dhe studentët prezent në takim. -Duhet kjo kurrikulë të vendoset në vitin e parë të bachelorit jo kur gjejnë hapësira në orare apo kur ka komoditet në riorganizimet e brendshme.- u pergjigj Dr. Reçi. Duhet që studentët sapa hyjnë në auditore duhet të njihen me formën e ndërtimit të detyrave deri ne formatin e diplomës.

Sugjerim për Ministrinë e Arsimit:

- *Duhet të rishikohen kurrikulat në shkollën e mesme, Gjuha Shqipe të eci paralelisht me Letërsinë edhe në shkollën e mesme.*
- *Të rritet cilësia e mësimdhënies të gjuhës shqipe në 9-vjecare, kjo do ndihmojë në përmisimin e cilësisë të shkrimit dhe leximit të gjuhës shqipe.*
- *Duhet kurrikula "Shkrimi Akademik" të vendoset në vitin e parë të bachelorit, dhe të zhvillohet me seriozitet dhe profesionalizëm.*

Në **nivel individual**, janë të shumta aksionet që mund të ndërmarrim. Tema e diskutimit të Dr. Qesari "Gjuha shqipe: shkrimi i gjymtuar si pasojë e leximit të munguar", thekson se arsyeja që ne shkruajmë keq është sepse në thelb ne lexojmë keq. Njerëzit kanë pak kontakt me librin, nga njëra anë s'ka motive të rritet koha e shëndetshme me librin, por edhe kur i dedikohet kohë leximit ato që lexojnë shkruhen keq. Njerëzit lexojnë njëri - tjetrin nëpër burime të ndryshme, por jo të gjitha burimet kalojnë filtrin redaktues. Kjo bëhet më problematike dhe kërkon ndërhyrje urgjente, kur një postim nga Facebook-u apo Twitter-i bëhet lajm. Tashmë një komunikim bashkëkohor, lajmi merret nga këto dy burime i papërpunuar e me mangësi redaktimi dhe qarkullon si lajm nëpër të gjitha televizionet apo rrjetet sociale.

Prof. Memushaj në prezantimin e tij "Prozodia dhe morfologjia, dy nga shtyllat kryesore të ngrehinës së gjuhës shqipe" theksoi se dy nga 4 shtyllat e gjuhës shqipe (leksiku-fjalori, morfologjia, sintaksa, prozodia apo intonacioni, theksi, melodia ritmi tempi etj) prozodia dhe morfologjia janë shpërfillur nga përdoruesit e gjuhës shqipe sidomos në këto dekadat e fundit ku numri i mjeteve mediatike është rritur në propocion të zhdrejtë me kualifikimin e folësve në lajme nëpër reklama apo në emisione dhe perkthime titrash filmash e kane rritur kete hendek dhe mos respektimin e dy shtyllave të sipër pëmendura. Problemet që i përkasin këtyre dy shtyllave të gjuhës shqipe janë:

Prozodia, kur një i huaj e di perfekt gramatikën e gjuhës shqipe prap ai kuptohet që është i huaj për shkak të ritmit të ligjërit, theksit. "Theksi në gjuhën shqipe qëndron në rrokjen e fundit të temës së fjalës ose si njësi fjalori-citon prof. Memushaj- vetëm kur bie zanorja e fundit atëhere e merr stafetën rrokja e disfundit. Këtu profesori i jep faj edhe librave të teksteve shkollorë që nuk analizojnë këtë rregull deri në fund por thonë që theksi bie në rrokjen e parafundit. Kujdes, edhe fjalët ndërkombëtare apo të huazuara duhet të ndjekin të njëjtin rregull në gjuhën shqipe.

Morfologjia, shtylla e dytë e gjuhës shqipe, ka të bëjë me emrin, sot ai nuk lakohet dhe këtu nuk flitet vetëm për emrat e huazuara por edhe për ato në gjuhën shqipe (psh i/e Covidit i/e Feisbukut, tek Megateku etj). Çdo fjalë në gjuhën shqipe kur lakohet merr mbaresa, duke mos i venë mbaresat prishet ekuilibri i frazës, humbet pesha dhe nuk e kupton në cilën rasë është. Shqipja ka një "aparaturë shumë të fuqishme" thekson prof. Memushaj, "i jep çdo fjale shqip apo e huazuar shtesa në lakime". Kjo e bën unike gjuhën shqipe sepse ndryshe nga çdo gjuhë tjetër në botë, i jep mbaresa, sado që ka edhe gjuhë të tjera që e kanë këtë rregull por nuk u japin dot mbaresa çdo lloj emri si shqipja.

Problemi i tretë që ne si individë harrojmë apo neglizhojmë, është përdorimi *shenjave të pikësimit*: pikëpyetjet, apostofat etj etj si edhe përdorimi i shkronjave që s'janë të gatshme në butonat e tastierës por formohen nga kombinimi i tyre si "ç" dhe "ë" e vogël dhe e madhe. Dr. Reçi, theksoi se mospërdorimi i tyre u jep fjalëve tjetër kuptim apo shpesh herë edhe keqkuptim. Fjalitë nga pyetëse kthehen në fjali dëftore apo urdhërore, si përshembull fjalja e studentëve "Do të mblidhemi në auditor" pa asnjë shenjë pikësimit, nuk përcakton dot llojin e fjalisë - urdhërore, pyetëse apo dëftore. E shkruar në këtë formë sjell shumë keqkuptime, sidomos nëse studentët kanë dashur të pyesin "A do të mblidhemi në auditor?" Sa larg është ndërtimi i fjalisë nga kuptimi i saj?!

Një nga metodologjitë më të sukseshme në mësimdhënie, "mësojmë duke u argëtuar" ka aplikuar edhe mësuesja e gjuhës shqipe Keti Sula. Ajo ka sjellë një risi në përdorimin e drejtë të shenjave të pikësimit, sintaksës, huazimet e fjalëve të reja që shpesh herë kanë

analogun e tyre në gjuhën shqipe dhe mbi të gjitha “ç” dhe “ë” e vogël dhe e madhe. Lojrat bëhen nëpërmjet rrjeteve sociale si një nga armët me të përdorshme nga rinia dhe masa.

Libri elektronik është mjeti me i dashur për të rinjtë në rrjetet sociale, instagram dhe facebook-thotë Znj.Sula. Sjellja tek lexuesit e librave me tematika të ndryshme si: filozofik, psikologjik bëhet me qëllimin jo vetëm për t'i ndihmuar dhe konsultuar ata por edhe për të ngjallur dëshirën dhe interesin për të lexuar sa më shumë.

Kjo nxitje ndihmon lexuesin, edhe nga ana vizuale, në procesin e të mësuarit saktë të gjuhës shqipe, format e rregullta të ndërtimit të fjalës, fjalisë, konteksteve, etj.

Përfundime:

- *Duhet të mësojmë ose t'i rifreskojmë rregullat e drejtshkrimit në gjuhën shqipe, kujdes 4 shtyllat e gjuhës shqipe dhe sidomos Prozodisë dhe Morfologjisë.*
- *Duhet të rritet koha e dedikuar leximit të librave dhe sa më pak atyre të rrjeteve sociale.*
- *Politikanët dhe personat publike të audiencës së gjerë, duke parë tendencën e fundit se si postimet në rrjetet sociale kthehen në lajme, duhet të shkruajnë sipas rregullave të drejtshkrimit, të gjejnë mënyra që postimet e tyre të kalojnë në filtra redaktues profesionalë.*

Ndikimet në nivele të ndryshme **institucionale dhe aktorë të tjerë** si shtëpitë botuese, bibliotekat, ndikojnë gjithashtu në procesin e vakëzimit të përdorimit sipas rregullave të gjuhës shqipe.

Mospërputhja mes shkrimit dhe leximit dhe cilësisë të shqipes, vjen edhe nga rritja e pafundme e shtëpive botuese, prodhimi në masë i librave, por shumë pak bibliografi, shtimi i përkthyesve, por pak profesionistë dhe akoma më shumë me mungesa në shqipërimi. Kjo e fundit tregon një dobësi edhe të njohjes së thellë të shqipes, shprehjeve frazeologjike, pasurimit në mbiemra, kulturë etj.

Bibliotekat që nga ato të shkollave, lagjeve deri tek ajo kombëtare, janë shumë pak ose aspak të frekuentuara. Është brezi i tretë ai që i frekuenton më shumë (për të lexuar gazetën). Vërtet duhet të ketë nxitje individuale për t'i frekuentuar, por edhe bibliotekat duhet të punojnë për rritjen e frekuentuesve, duhet të reklamojnë vetveten apo të organizojnë në çdo lagje takime për të folur për librin apo të informojnë mbi rrisitë në gjuhën shqipe, etj.

Në institucione shtetërore shpesh herë gjen shkresa me gabime që nga ato sintaksore deri tek mungesat e shenjave të pikësimit apo shkronjave ç dhe ë. Një dokument i tillë ç' edukon qytetarët. Për këtë arsye kërkohet që në çdo institucion shtetëror dhe privat si dhe administratat respektive të kenë një filtër korrektues gjuhësor dhe korrektor profesionist.

Nuk janë të pakta konferencat dhe seminarët që organizohen mbi gjuhën shqipe, si nga katedra e gjuhës shqipe apo edhe nga operatorë apo autoritete të tjera që dalin me vendime mbi rregulla të reja për zhvillimin e gjuhës shqipe. Sipas Dr. Reçit janë shumë cilësorë, por ka një hendek, këto risi shumë pak ose aspak nuk promovohen në kohë reale si informacion tek palët e interesuara. Duhet që secili prej nesh të informohet dhe të mundohemi t'i përdorim në maksimum.

Institucionet e arsimit të lartë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve duhet të propozojnë mundësira se si të realizojnë dy produktet që dolën nga takimi: tastiera me shkronjat shqipe dhe një aplikacion korrektor të shqipes, i cili mund të jetë në ndihmë të studentëve gazetarëve pse jo edhe institucioneve administrative.

Përfundime:

- *Shtëpitë botuese duhet të jenë më përzgjedhëse në cilësinë e përkthimeve të librave. Përkthyesit duhet të jenë më kërkues dhe hulumtues, në kulturën tonë dhe në pasurimin e gjuhës me mbiemra, antonime, sinonime, etj.,*
- *Bibliotekat e shkollave, lagjeve apo ajo kombëtare duhet të rrisin transparencën, marketingun dhe disa prej tyre edhe të përmirësojnë kushtet.*
- *Institucionet dhe administratat publike e private duhet të marrin patjetër pranë tyre një korrektor profesionist që të mos sjellin keqkuptime dhe të ç'edukojnë qytetarët në mënyrë të padukshme.*
- *Të promovohen në kohë reale të gjitha risitë që vijnë nga katedra apo nga seminare dhe konferenca të ndryshme. Mund të organizohen tavolina rrumbullake në biblioteka apo të përshkallëzohet informacioni edhe në qytete të ndryshme.*
- *Përqaftimi i teknologjisë është i nevojshëm, duhen të thirren projekte në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve apo IAL-ve për të zhvilluar dy produktet më urgjente të nxjerra si nevojë nga takimi: Tastiera me shkronja në gjuhën shqipe dhe auto-korrektori i gjuhës shqipe.*

Shqipja është në zhvillim prandaj edhe ajo duhet ta përqafojë zhvillimin e teknologjisë duke u pasuruar me terma të huazuara, sduhet të trembemi prej saj por të mbajmë fort shqipen e strukturuar që ka arritur deri në ditën e sotme.